



Raporti i - IV - | Për Muajin MAJ 2010

Monitoruesi i Korrupsionit

Raporti i Monitorimit mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë
Kundër Korrupsionit

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga USAID-i përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile i implementuar nga Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Institute for Sustainable Communities). Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e USAID ose ISC.



MONITORUESI I KORRUPSIONIT

PËRMBAJTJA

H y r j e.....	4
Përmbledhje.....	5
Qeveria e Kosovës.....	6
Kuvendi i Kosovës.....	8
Sistemi Gjyqësor.....	9
Prokuroria e Shtetit.....	9
Këshilli Gjyqësor i Kosovës.....	9
Agjencia Kundër Korrupsionit.....	10
Doganat e Kosovës.....	11
Policia e Kosovës.....	11
Raportet Ndërkombëtare.....	12
Këshilli Kombëtar mbi Politikën e Jashtme Amerikane.....	12
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut.....	13
Raportet nga Shoqëria Civile.....	14
Lëvizja “FOL”	14
Organizata “Çohu”.....	14
Falënderime.....	15
Rreth Lëvizjes “FOL”	15

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

LISTA E AKRONIMEVE

AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKK – Agjencia Kundër Korrupsionit

AKR – Aleanca Kosovare e Re

ANP – Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës

EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

ICO – International Civilian Office (Zyra Civile Ndërkombëtare)

ISC – Institute for Sustainable Communitities (Instituti për Komunitete të Qëndrueshme)

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KQZ – Komisioni Qendror Zgjedhor

LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MTPT – Ministria e Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit

NCAPF – National Committee on American Foreign Policy (Këshilli Kombëtar mbi Politikën e Jashtme Amerikane)

PDK – Partia Demokratike e Kosovës

PTK – Postë-Telekomi i Kosovës

SHIK – Shërbimi Informativ i Kosovës

USAID – United States Agency for International Development (Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar)

YIHR – Youth Initiative for Human Rights (Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut)

ZPD – Zyra e Prokurorit Disiplinor

PËRMBLEDHJE

- Qeveria e Kosovës nuk ka shënuar ndonjë aktivitet konkret në luftën kundër korrupsionit. Zotimet e Kryeministrit Hashim Thaçi, dhe vartësve të tij, për ‘zero tolerancë ndaj korrupsionit’ ka shënuar muajin Maj, madje duke u shndërruar në retorikë. ‘Monitoruesi i Korrupsionit’ e vlerëson përpjekje pozitive vendimin e Qeverisë së Kosovës, që për çdo tender, shuma e të cilit kalon mbi 9 mijë euro, të nënshkruhet nga tre zyrtarë, përfshirë edhe Ministrin.
- Kuvendi i Kosovës përgjatë Majit ka mbajtur dy seanca plenare. Në agjendën legislative nuk është adresuar asnjë çështje për korrupsionin. Ngjashëm kanë vepruar edhe deputetët kosovarë. Shqetësimi i vetëm i tyre është fokusuar për vonesat në miratimin e ligjeve përkatëse, dhe natyrshëm janë shfaqur mos pajtimet ndërmjet deputetëve në pushtet dhe opozitës për çështje të politikës ditore. Për dallim nga periodiku i Majit, ‘Monitoruesi i Korrupsionit’ në Prill ka raportuar për aktivitet më të ngjeshur të Kuvendit të Kosovës, veçmas deputetëve, në adresimin e luftës kundër korrupsionit.
- Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (lexo: AKK) ka ndërmarr një sërë veprimesh konform zotimeve të saj dhe obligimeve kushtetuese. Përpos përpilimit të dosjeve të zyrtarëve të lartë me deklaratimet e pasurisë së tyre, AKK ka nënshkruar marrëveshjen me Policinë e Kosovës, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve ndër-institucionale në luftën kundër korrupsionit. Në të njëjtën kohë, ky institucion ka ngritur dyshimet për keqpërdorimin e miliona eurove në PTK. Ndarja e 20 milionë eurove për softuerin e faturimit, i cili do të përgatitet prej kompanisë “Amdocs” nga Qiproja, me qëllim që Telekomit dhe VALA të operojnë me platforma të ndara të faturimit, po hulumtohet nga Agjencia. Provat për rastin pritet ti dërgohen Prokurorisë së Kosovës.
- Policia e Kosovës ka arrestuar tre zyrtarë komunalë në Prizren, nën dyshimin për shpërdorim të pozitës zyrtare, marrje të ryshfetit dhe mashtrim.
- ‘Monitoruesi i Korrupsionit’ ka evidentuar përgjatë Majit një sërë deklaratash kritike të zyrtarëve të partisë në pushtet, PDK, ndaj raporteve të disa organizatave jo qeveritare: *Këshillit Kombëtar mbi Politikën e Jashtme Amerikane*, *Nismës së Të rinjve për të Drejtat e Njeriut dhe ÇOHU-t*. Raporti i organizatës amerikane adreson kritika të shumta në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar, e që sipas tij, rrezikon procesin e ndërtimit të shtetit dhe demokratizimin e vendit. Qëndrime të ngjashme kanë adresuar edhe raportet e dy organizatave tjera.
- Në kuadër të aktiviteteve të shoqërisë civile, Lëvizja “FOL” ka publikuar listën me emrat e zyrtarëve që në kundërshtim me ligjin, mbajnë funksione të dyfishta në institucionet publike duke përbër konflikt interesi. Organizata “Çohu” ka publikuar raportin e saj në lidhje me dobësitë dhe dështimet e Kornizës Ligjore në sferën e Luftës Kundër Korrupsionit.
- Prokuroria e Kosovës, është duke punuar me 69 raste, të cilat kanë të bëjnë me krime financiare;

H Y R J E

Korrupsioni, i vlerësuar si sfida kryesore për shoqërinë e Kosovës përgjatë 11 viteve të tranzicionit, vazhdon të mbetet shqetësim i përbashkët i të gjithëve. Politikanëve, shoqërisë civile e mediave. Ndërkombëtarët adresojnë këtë çështje në raportet/vlerësimet e tyre të përvitshme dhe qëndrimet deklarative. Bashkimi Evropian me Raportet e Progresit, e Departamenti Amerikan i Shtetit me raportet periodike për çështje të veçanta, mbasin vërejtjet publike që Kosova i merr pothuasje rregullisht viteve të fundit. Ndërsa raportet e organizatave jo qeveritare ndërkombëtare për Kosovën, kanë qenë të vazhdueshme dhe shpesh herë më të ashpëra në adresimin e korrupsionit. Shto kësaj edhe qëndrimet deklarative të teknokratëve ndërkombëtarë, lehtësisht mund të konstatohet që korrupsioni dhe lufta kundër tij, asnjëherë, kudo dhe kurdo, nuk është plotësisht i çrrënjësor.

Vendasit mbeten të ndarë në qasjen për korrupsionin dhe luftën kundër tij. Përderisa pushtetarët zotohën për ‘zero tolerancë korrupsionit dhe krimin të organizuar’, opozita adreson të kundërtën, duke e cilësuar ‘qeverinë – koka e korrupsionit’. Qëndrimet e tyre për çështjen në fjalë ndryshojnë me ndërrimin e pushtetit, e bashkë me të edhe rolet e tyre. Përgjatë qeverisjes nën administrimin e UNMIK-ut, dhe pas shpalljes së pavarësisë, publiku kosovar në rolin e spektatorit ka mundur të përcjell rrokadën e pushtetit dhe retorikën pothuasje boshe për luftën kundër korrupsionit. Çështja e statusit, e më pas bërja e shtetit, janë shndërruar Atutë kryesore pas të cilave politikanët kosovarë janë fshehur vazhdimisht.

Dy vite pas shpalljes së pavarësisë, raportimet investiguese të mediave për korrupsionin, instalimi i Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit, EULEX, dhe forcimi i thirrjeve të shoqërisë civile, kanë prioritetizuar ‘luftën kundër korrupsionit’. Edhe pse arrestimi i ‘peshqve të mëdhenj’ është zëvendësuar me të vegjëlit, madje në nivel komunal, pritet që ndërkombëtarët dhe Kryeministri Thaçi kanë krijuar për qytetarët, do ta shoqëroj edhe për një kohë politikën ditore në Kosovë.

Lëvizja FOL vazhdon monitorimin e aktiviteteve të institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit. Në periodikun e katërt me radhë, për muajin Maj, është shënuar një aktivitet më i ngjeshur të paktën deklarativ nga institucionet publike, veçmas nga Qeveria e Kosovës. Arrestimi i disa zyrtarëve në nivel komunal është gjithçka që shënon Maji, në periodikun e rregullt të FOL-it ‘Monitoruesi i Korrupsionit’, sa i përket prangosjes së të korruptuarve. Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit ka nënshkruar një marrëveshje me Policinë e Kosovës me qëllim të bashkërendimit të punës në luftën kundër korrupsionit. Disa organizata jo qeveritare, një amerikane e të tjera vendase, kanë adresuar korrupsionin përmes raporteve.

QEVERIA E KOSOVËS

Qeveria e Kosovës, marrë në totalitetin saj, nuk është shquar për ndonjë aktivitet të ndërmarrë në luftën kundër korrupsionit. Kjo luftë, nëse mund të quhet e tillë, është reduktuar vetëm në suazat e deklarimeve dhe prononcimeve nga ana e zyrtarëve të lartë qeveritarë. Prandaj, ligjërimet për “zero tolerancë ndaj korrupsionit, zotim dhe luftë të pamëshirshme karshi tij”, kanë ngelur vetëm fjalë boshe dhe nuk kanë ndikuar në flakjen e këtij “djalli të shoqërisë kosovare”.¹ Pas bastisjeve së EULEX-it në MTPT dhe në pronat private të z. Limaj dhe z. Krasniqi, qeveria e Kosovës, në vend që të dilte publikisht për të shpjeguar shkaqet e një bastisjeje të tillë, kishte parapëlqyer më shumë heshtjen dhe strukjen në qoshe! Gjatë kësaj kohe, më e zhurmshme ka qenë opozita, e cila në vazhdimësi ka kritikuar qeverinë e Kosovës, duke theksuar që “Kosova e pavarur udhëhiqet nga institucione të korruptuara dhe të kompromentuar.”² Pas një heshtje të gjatë, më në fund Kryeministri Thaçi, në një intervistë për RTK-në, hodhi një mal akuzash në drejtim të strukturave ndërkombëtare, të cilat, sipas mendimit të tij, ishin të udhëhequra nga ideja për linçime politike dhe assesi s’ishin hetime të njëmendta për korrupsion dhe krim të organizuar.³ Ndërkaq, nga perspektiva e opozitës, “mënyra sesi EULEX-i kishte lansuar ndërmarrjen e tij të hetimit të korrupsionit, ka treguar pafuqinë e

Qeverisë së Kosovës së Kryeministrit Thaçi, e cila më parë ka dëshmuar pafuqinë dhe mungesën e vullnetit për t’u marrë me kërcënimin e korrupsionit i cili është lokalizuar, në radhë të parë, pikërisht në instancat qeverisëse, në të gjitha Raportet e rëndësishme ndërkombëtare.⁴ Edhe nga optika e EULEX-it, ky procesi i hetimeve për rastet e mëdha të korrupsionit nuk është bërë për arsye politike. Madje, sipas zëvendës shefit të EULEX-it, Roy Reeve, paralajmëroi se në javët e ardhshme do ta bëjë të qartë se nuk ka për objektiv vetëm zyrtarët e lartë ose ministrat e qeverisë së Kosovës. Reeve tha se hetimi në njërin nga ministrat e qeverisë së Kosovës është vetëm fillimi i “një beteje të gjatë dhe të vazhdueshme” dhe të përbashkët me institucionet e Kosovës, me qëllim të luftimit të korrupsionit në institucionet e qeverisë ose në ato private⁵. Prokurorët e këtij misioni, krahas hetimeve në rastin Limaj, po i hetojnë edhe gjashtë raste të tjera të krimit të organizuar, ku janë të përfshirë zyrtarë të lartë, ndërkaq numri i rasteve të korrupsionit në nivele më të ulëta është edhe më i lartë. Sipas këtij misioni, numri i rasteve ku dyshohet për korrupsion në të gjitha nivelet, përfshirë edhe atë lokal, kalon shifrën 100.⁶ Mirëpo, brenda pak kohe, kritikantët e kryeministrit kundrejt strukturave ndërkombëtare u relativizuan theksueshëm dhe, rrjedhimisht, diskursi u zhvendosë drejt korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke pohuar që “institucionet e Kosovës kanë bashkëpunim të ngushtë me ICO dhe EULEX-in

¹ Marcus BENTLER – Intervistë për gazetën Kosova Sot, 31 Maj 2010, fq. 3

² Besnik KRASNIQI – Haradinaj: Kosova udhëhiqet nga institucione të komprometuar, Koha Ditore, 3.05. 2010, fq. 4

³ Intervistë e Kryeministrit THAÇI për “rastin Limaj”, mbajtur në RTK, 3 Maj 2010

⁴ Blerim SHALA – Dëmtimi i Shtetit, gazeta Ekspress, 10 Maj 2010, fq. 3

⁵ www.koha.net, - EULEX-i i vendosur për hetimin e korrupsionit –26 Maj 2010

⁶ Arben AHMETI – EULEX-i paralajmëron “verë të nxehtë”, Koha Ditore, 30 Maj 2010, fq. 2

për luftimin e korrupsionit⁷. Megjithatë, si pasojë e nivelit të lartë të korrupsionit dhe pas vlerësimeve negative që Komisioni Evropian i ka dhënë sistemit të prokurimit publik, Qeveria e Kosovës ka pohuar se ka vendosur që të intensifikojë procesin e reformave dhe të ndërmarrë një numër masash, të cilat do të transformonin rrënjësisht sistemin e prokurimit. Në këtë kuadër, Qeveria e Kosovës është duke e rishikuar Ligjin e prokurimit, Ligjin mbi partneritetin publiko-privat dhe për koncesionet, si dhe duke emëruar borde të reja të organeve kryesore të prokurimit⁸. Në këtë drejtim, kryeministri Thaçi ka filluar intensifikimin e përpjekjeve në luftë kundër korrupsionit, duke nxjerrë një vendim administrativ, i cili përcakton që nënshkrimi i kontratave me vlerë mbi 10 mijë euro, përveç nga drejtori i Prokurimit Publik, do të bëhet edhe nga sekretari i përhershëm, nga zyrtari më i lartë administrativ dhe nga ministri. Megjithatë, nga prizmi i AAK-së, ky vendim, jo vetëm që nuk do të zvogëlojë mundësitë për korrupsion, por vetëm sa do t'i shtojë ato, pasi që ministrit i jepet mundësia të ndërhyjë në punët e administratës dhe të vendosë në fund kujt t'i jepet tenderi.⁹ Një qëndrim të tillë ndanë edhe deputeti i AKR-së, Riza Smaka, sipas të cilit, ky udhëzim nuk është një ndihmë në luftën kundër korrupsionit.¹⁰ Megjithatë, nga perspektiva qeveritare, ky vendim konceptohet si një hap dhe betejë konkrete në luftë kundër

korrupsionit.¹¹ Përveç këtij vendimi, kryeministri i Kosovës ka realizuar edhe një takim të përbashkët me ministrin e Punëve të Brendshme, Kryeprokurorin e Shtetit dhe drejtorin e Policisë së Shtetit. Në këtë takim, është akorduar për t'i bashkërenduar aktivitetet institucionale në luftë kundër korrupsionit, me ç'rast, edhe Kryeministri kishte deklaruar se “qeveria do të mbështes fuqishëm të gjitha institucionet në luftë kundër korrupsionit, në mënyrë që toleranca ndaj korrupsionit të vazhdojë të jetë zero”.¹² Ajo që është e rëndësishme të nënvizohet në këtë Raport, është edhe koncesioni i Aeroportit të Prishtinës. Pas akuzave të disa kompanive se koncesioni i ANP-së është manipuluar, ndërkombëtarët janë kujdesur që ta mbrojnë këtë proces. Pas shefit të ICO-së, Peter Feith, në mbrojtje ka dalë edhe drejtuesi i ekipit këshillues i NACO, Hans Mohrman, i cili kishte pohuar që “që nga dita e parë, ky proces është menaxhuar me transparencë absolute dhe profesionalizëm, pa asnjë ndërhyrje politike¹³. Edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Christofer Dell, kishte deklaruar se koncesioni i APP-së paraqet një ndryshim të paradigmës për Kosovën... duke i treguar botës se Kosova është e aftë të veprojë me përgjegjësi, transparencë, dhe profesionalizëm..ndaj edhe Qeveria e Kosovës dhe konsorciumi fitues duhet të përgëzohen¹⁴.

⁷ Një pohim i tillë është thënë në një takim me shefin e ICO. Më gjerësisht shih <http://www.koha.net>, 31 Maj 2010

⁸ Vatra QEHAJA – Komisioni Evropian kërkon borde të reja në institucionet e prokurimit, Koha Ditore, 3 Maj 2010, fq. 8

⁹ Ahmet ISUFI – prononcim për gazetën Ekspress: Skeptikët për reformat, 31 Maj 2010, fq. 10

¹⁰ Po aty, fq. 10

¹¹ <http://www.kryeministri-ks.net>, 26 Maj 2010

¹² Po aty, 31 Maj 2010

¹³ Agon SINANAJ – Proces jo politik, gazeta Ekspress, 17 Maj 2010, fq. 10

¹⁴ <http://albanian.pristina.usembassy.gov>, 19 Maj 2010

KUVENDI I KOSOVËS

Kuvendi i Kosovës, gjatë gjithë muajit maj, ka mbajtur vetëm dy seanca plenare. Gjatë këtyre seancave nuk është vërejtur ndonjë vullneti i spikatur nga ana e deputetëve për të diskutuar për aferat korruptive. Janë ngritur kryesisht shqetësime që kanë të bëjnë me mosmiratimin e ligjeve përkatëse dhe për dilemat e shumta për procesin e privatizimit. Megjithatë, nëse krahasojmë seancën e parë me atë të dytën, rezulton që, në seancën e dytë, është diskutuar me tepër për korrupsionin dhe krimin e organizuar, ku është evidentuar edhe një spektër më i gjerë i deputetëve që kanë ngritur shqetësimet e tyre për abuzimin e parasë publike nga ana e Qeverisë së Kosovës. E vetmja pyetje nga seanca e parë, e parashtruar gjatë kohës së pyetjeve parlamentare dhe e cila ndërlidhet me denoncimin e aferave korruptive, është bërë nga Driton Tali, në lidhje me pajisjen e shkollave me teknologji informative, që është dhënë 24 milionë më shtrenjtë nga ana e MASHT-it.¹⁵ Mirëpo, mungesa e pranisë së ministrave, e veçanërisht ajo e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, është duke e ngulfatur dhe, në njëfarë mënyre, duke e pamundësuar funksionimin e nenit 26 të Rregullores së Re të Kuvendit¹⁶ – që krijon hapësirë solide për deputetët e interesuar që të parashtrojnë pyetje parlamentare në adresë të kabinetit qeveritar. Ndërkaq, gjatë diskutimit për ndërmarrjet publike, të iniciuar me mocionin e 11 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Qeveria e Kosovës nuk e ka sjellë

raportin për gjendjen në këto ndërmarrje, me arsyetimin se auditimet ende nuk kanë përfunduar, andaj ka qenë e pamundur që të hartojë raportin. Iniciuesi i këtij mocioni parlamentar, Driton Tali, ka thënë se Qeveria, që nga fillimi i mandatit të saj, nuk ka bërë diçka për të ndryshuar gjendjen në këto ndërmarrje. Sa i përket KEK-ut, ai ka thënë se në këtë ndërmarrje vazhdon trendi i dhënies së tenderëve për kompanitë jokompetente dhe kriminale. Sipas tij, hiq më mirë nuk është as gjendja në PTK.¹⁷ Një brengë të tillë kishte shprehur edhe Kompania “PA Consulting”, e përbërë nga një grup këshilltarësh të Korporatës Energjetike dhe të cilët financohen nga Agjencia Amerikane për Zhvillim, USAID. Kjo kompani kishte vlerësuar se buxheti i Kosovës është dëmtuar për miliona euro nëpërmjet tenderëve për import të energjisë elektrike të kryer nga KEK-u. Sipas këshilltarëve të kësaj kompanie, ka qenë e pamundur të bindet kushëriri i Kryeministrit i Kosovës, Nijazi Thaçi, për mosnënshkrimin e kontratave me kompanitë serbe “EFT” e “Rudnap”, me çmime për 20 për qind më të larta. Prej këtyre kontratave vlerësohet se buxheti i Kosovës është dëmtuar për 8 milion euro.¹⁸ Ndërkaq, në seancën e dytë, deputeti Naim Rustemi, ka ngritur çështjen e tenderit për operatorin virtual, i cili sipas tij, është një mashtrim tjetër i radhës, ngase dy ofertuesit – Dardafone dhe Dardafone.net janë i njëjti ofertues, mirëpo më këtë synohet t’i qitet hi syve opinionit publik, ndaj edhe mënyra sesi është dhënë tenderi është plotësisht e papranueshme dhe natyrisht që ka pasur shkelje të mëdha në

¹⁵ Transkripti i Seancës Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbajtur me 13 dhe 17 Maj, 2010, fq. 11

¹⁶ Neni 26 i Rregullores së Kuvendit të Kosovës, miratuar me 20 Maj 2005, e ndryshuar dhe e plotësuar me 1 Qershor 2006.

¹⁷ Vatra QEHAJA – Opozita akuzon Qeverinë për korrupsion në ndërmarrjet publike, Koha Ditore, 14 Maj 2010, fq. 9

¹⁸ Parim ULLURI – Kushëriri i kryeministrit dëmtoi buxhetin për disa miliona euro, Koha Ditore, 13 Maj 2010, fq. 8

dhënien e këtij tenderi.¹⁹ Edhe deputeti tjetër i pavarur, Driton Tali, ka ripërsëritur pyetjen e njëjtë nga seanca paraprake, por edhe në këtë seancë kishte mbetur pa përgjigje, meqë ministri Enver Hoxha nuk ishte i pranishëm. Në anën tjetër, deputeti i AKR-së, Riza Smaka, ka adresuar kritika të shumta në adresë të gjykatave dhe gjyqësorit, ngase sipas tij, ekzistojnë mijëra lëndë të pazgjidhura, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me afëra korruptive. Mirëpo, debati është “nxehur” rreth korrupsionit dhe krimit të organizuar, kur deputeti i AAK-së, Shkumbin Demaliaj, ka shprehur mllefin e tij për “zhburrimin e institucioneve të Kosovës nga ana e EULEX-it”, në rastin e bastisjes së MTPT-së. I menjëhershëm ka qenë edhe reagimi i Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili ka pohuar që “Qeveria e tij është qeveria e parë që ka filluar luftën ndaj korrupsionit”. Më tutje, ai, ka pohuar që lufta ndaj korrupsionit nuk do të përfshijë vetëm periudhën e tij qeverisëse, por tërë periudhën e pas-luftës, kështu që do të sqarohen të gjitha rastet korruptive dhe të krimit të organizua. Thaçi, më këtë rast, ka thënë se qeveria do të jetë bartëse e kësaj lufte, ndërsa EULEX do të ndihmojë dhe do të ketë rolin e lehtësuesit.

SISTEMI GJYQËSOR

Njëra ndër pushtetet më të rëndësishme, të cilitdo sistem politik, është edhe pushteti gjyqësor. Ky pushtet, nëse është i paanshëm dhe i pavarur, atëherë apriori siguron dhe kufizon çdo lloj mundësie për shpërdorim të parasë publike apo edhe për keqpërdorimin e pozitës zyrtare. Në këtë kontekst, njëra nga arsyet pse korrupsioni dhe krimi i organizuar

është shtrirë gjithandej institucioneve, është edhe zhytja e vet sistemit gjyqësor në korrupsion dhe rënia e tij në grackën e presioneve dhe interferimeve politike. Prandaj, meqë demokracitë assesi nuk mund të funksionojnë pa sistemin gjyqësor, ngase garanton dhe kontrollon pushtetet tjera, atëherë edhe Kosova duhet të ndërmarrë hapa të shpejtë dhe seriozë për reformimin e thellë të saj.

PROKURORIA E KOSOVËS, e cila vepron në kuadër të sistemit gjyqësor, nuk ka shënuar ndonjë aktivitet të veçantë gjatë muajit maj në luftë kundër korrupsionit. Megjithatë, është raportuar se, Prokuroria e Shtetit, aktualisht është duke u marrë me 69 raste, të cilat kanë të bëjnë me krime financiare²⁰, mirëpo pritet që gjatë muajit qershor të sqarohen më shumë detaje në lidhje me këto raste. Gjithashtu, kryeprokurori i Kosovës, Ismet Kabashi, ka realizuar një takim me kryeministrin Thaçi për të marrë mbështjen e tij institucionale në luftë kundër korrupsionit dhe çfarëdo mënyre tjetër të shpërdorimit me detyrën zyrtare. Ndërkaq, sa i përket marrëveshjes së paralajmëruar me AKK-në, kjo marrëveshje nuk është nënshkruar gjatë muajit maj, por vetëm në fillim të muajit qershor. Prandaj, me pak fjalë, Prokuroria nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim serioz, i cili do të mund të specifikohet në kuadrin e një rëndësie përmbajtësore.

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, i cili siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale dhe të paanshme, nuk ka arritur deri me tani t’i mbledhë statistikën e rasteve që kanë të bëjnë me marrje të ryshfetit, dhënie të ryshfetit dhe shpërdorim të detyrës

¹⁹ Monitorimi i Kuvendit të Kosovë nga stafi i Lëvizjes FOL, 27 Maj 2010

²⁰ Jeton MUSLIU – Hetohen 69, gazeta Ekspress, dt. 14 Maj 2010, fq. 8

zyrtare.²¹ Është raportuar, po ashtu, se KGJK-ja vazhdon edhe më tutje t'i zvarrisë rreth 40 lëndë të dorëzuara nga Zyra e Prokurorit Disiplinor. Vetëm gjatë muajit prill, KGJK-ja ka pranuar gjithsej 30 ankesa disiplinore dhe 10 sosh në muajin maj. Megjithatë, ZPD-ja nuk e ka pranuar asnjë vendim me shkrim nga Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e ndonjë rasti. Zyrtarët e këtij institucioni kanë reaguar vazhdimisht ndaj neglizhencës së KGJK-së në shqyrtimin e rasteve që ata adresojnë për t'u zgjidhur. Koordinator i ZPD-së, Kadri Begolli, ka thënë se Komisioni Disiplinor për një periudhë të gjatë kohore ka qenë jofunksional, sikurse edhe vet KGJK-ja. Madje, sipas tij, këto lëndë nuk janë duke u zgjidhur me qëllim, ngase ekziston interesimi për keqpërdorim. Më tutje, ai thekson se nëse ndodhë që KGJK-ja të bëjë parashkrimin e këtyre lëndëve, atëherë kjo çështje do të shkojë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës²².

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

Angazhimet kryesore të Agjencisë Kundër Korrupsionit, gjatë tërë muajit maj, kanë qenë të orientuara në shtyrjen e zyrtarëve publikë për të deklaruar pasurinë e tyre. Këto përpjekje, megjithatë, janë kurorëzuar vetëm në fillim të muajit qershor, ku është publikuar lista e të gjithë zyrtarëve të cilët e kanë deklaruar pasurinë e tyre, si dhe atyre të cilët nuk e kanë bërë një veprim të tillë. Në të njëjtën kohë, AKK-

ja, në fillim të muajit që lamë pas, ka dyshuar për keqpërdorimin e miliona eurove në PTK, meqenëse PTK-ja kishte ndarë 20 milionë euro për softuerin e faturimit, i cili do të përgatitet prej kompanisë “Amdocs” nga Qiproja, me qëllim që Telekom dhe VALA të operojnë me platforma të ndara të faturimit. Sipas Agjencisë, dyshohet se buxheti i Kosovës është dëmtuar për miliona euro në këtë rast²³, ndaj edhe është premtuar nga ana e saj se, ky rast, do të hulumtohet në tërësi dhe pasi të mbledhin provat dhe faktet përkatëse, do t'i dërgohen Prokurorisë, e cila më pastaj mund të zhvillojë hetime të mëtutjeshme. Kjo Agjenci, po ashtu, ka realizuar një sërë aktiviteteve që, sipas mendimit tonë, do të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e pozicionit të saj karshi luftës së korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këtë kontekst, në vazhden e marrëveshjeve të realizuara të AKK-së me institucionet tjera, është konkretizuar edhe marrëveshja e nënshkruara me Policinë e Kosovës, e cila pritet të ndihmojë në bashkërendimin e aktiviteteve institucionale në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sipas kësaj marrëveshje, palët do t'i ofrojnë njëra tjetrës informata për çështjet që janë me interes të dyanshëm:

a) komunikim dhe shkëmbim të të dhënave; b) koordinim të punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta për zbulimin dhe hetimin e korrupsionit në bazë të ligjit nr. 03/L- 159; c) ofrimin e këshillave të ndërsjella në zgjidhjen e problemeve të natyrave të ndryshme anti-korrupsion; d) Policia e Kosovës, me kërkesë të Agjencisë, do të vë në dispozicion të Agjencisë dokumentacionin e kërkuar, që lidhen me zbulimin dhe hetimin e korrupsionit; e) në rast se natyra e veprave penale si dhe mënyra e kryerjes i

²¹ Mirëpo, është premtuar nga ana e tyre që statistikën do t'i mbledhin deri në fund të muajit maj, ndaj edhe Lëvizja FOL do t'i inkorporojë ato në Raportin e ardhshëm, pra të qershorit.

²² Betim MUSLIU – Flenë dosjet e gjykatësve dhe të prokurorëve, gazeta LAJM, 31 Maj 2010, fq. 8

²³ Parim ULLURI dhe Agron HALITAJ – Antikorrupsioni dyshon për keqpërdorim të miliona eurove në PTK. Koha Ditore. 9 Maj 2010, fq. 5

tejkalon kompetencat e AKK-së, atëherë dosja do të kalojë në PK; f) Policia e Kosovës mund të kërkojë ndihmën e AKK-së në hetimin e rasteve të dërguara nga Agjencia; g) AKK-ja, në rastet kur hasë në vështirësi në mbledhjen e informacioneve, mund të kërkojë ndihmën e Policisë.²⁴

Prandaj, kjo marrëveshje do të ketë efekte të drejtpërdrejta në prodhimin e rezultateve më të theksuara nga ana e AKK-së. Përveç kësaj, do të krijojë edhe hapësirë më të madhe për bashkëpunim ndër-institucionalë, ngase lufta ndaj korrupsionit, siç është e njohur, kërkon dhe presupozon një bashkërendim të aktiviteteve të të gjitha institucioneve, të cilat janë përgjegjëse për ta luftuar korrupsionin.

DOGANAT

Statistikat e anti-korrupsionit të Doganave të Kosovës, për muajin Maj, tregojnë se është shqiptuar vetëm një masë disiplinore. Kjo masë, megjithatë, ka qenë vetëm vërejtje me gojë – për shkak të sjelljes jo profesionale. Edhe në Sektorin e Standardeve Profesionale është iniciuar njashu 1 rast (subjekt procedural-zyrtar), për shkak të dëmtimit të automjetit zyrtar të Doganës.²⁵ Ndërkaq, auditorët e brendshëm të Doganave të Kosovës, i kanë kërkuar krye-doganierit Naim Huruglica që të merret me humbjet milionëshe të shkaktuara nga lëshimi që u është bërë kompanive importuese të duhanit. Ndërkaq, ky i fundit ia ka “dorëzuar” kompetencat EULEX-it që të

merret me problemin e pagesës së akcizës nga korporatat e duhanit.²⁶

POLICIA E KOSOVËS

Zyrtarët e Policisë së Kosovës nuk kanë shprehur, as gjatë muajit maj, vullnetin e tyre për të bashkëpunuar. Megjithëse Lëvizja FOL, prej janarit 2010, ka adresuar disa kërkesa zyrtare për qasje dhe bashkëpunim në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun, ende nuk ka marrë asnjë përgjigje – qoftë pozitive - qoftë negative. Megjithatë, në një takim që ka zhvilluar stafi i FOL me zyrtarë të lartë të Policisë, është premtuar nga ana e tyre që, gjatë muajit qershor, dyert e tyre do të jenë të hapura për t'i parë përpjekjet dhe aktivitetet e Policisë së Kosovës në luftën e saj kundër korrupsionit. Megjithëkëtë, Policia e Kosovës, gjatë muaji që lamë pas, ka realizuar një sërë aktiviteteve që ndërlidhen me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ajo që do të mund të veçohej është nënshkrimi i memorandumit me AKK-në, realizimi i një takimi të përbashkët me kryeministrin, ministrin e punëve të brendshme dhe me kryeprokurorin e shtetit, si dhe arrestimi i tre zyrtarë për keqpërdorim të detyrës zyrtare, marrje të ryshfetit dhe mashtrim. Të dy pikat e para janë shtjelluar tashmë, kështu që është më rëndësi të nënvizohet vetëm aktiviteti i tretë. Sipas Policisë së Kosovës, të arrestuarit Ibrahim A. dhe Mehmet S. (zyrtarë në drejtorinë e Kadastrës në Prizren) dyshohet se kanë marrë 90.000 Euro nga viktima në emër të parcelës numër 142/2 zona kadastrave Petrovë - komuna e Prizrenit, e cila tani në bazën e të dhënave të Kadastrës në Prizren figuron si pronë e “KBI PROGRES”, kurse e dyshuara tjetër, Ajsela L.

²⁴ Agjencia Kundër Korrupsionit – AKK-ja dhe Policia e Kosovës nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit. Publikuar në <http://www.akk-ks.org>, dt. 28.05.2010

²⁵ Statistikat e Doganave të Kosovës – Raporti për muajin Maj 2010

²⁶ Parim OLLURI – EULEX-i heton 2 milion eurot kontestuese të Doganave, Koha Ditore, 11 Maj 2010, fq. 8

(punëtore në Drejtorinë e Kadastrës, e cila është përgjegjëse për lëshimin e fletëve poseduese) dyshohet se ka marrë 10.000 Euro ryshfet për të lëshuar fletën e posedimit që dyshohet të jetë e falsifikuar.²⁷

RAPORTET NDËRKOMBËTARE

Të gjitha Vlerësimet dhe Raportet ndërkombëtare, që vizatojnë dhe pasqyrojnë zhvillimet e gjithëmbarshme në Kosovë, shpërfaqin një nivel të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Dhe, më pastaj, institucionet e shumta ndërkombëtare, mbi bazën e këtyre Raporteve, i artikulojnë dhe shprehin shqetësimet e tyre për shkallën e lartë të shtrirjes së korrupsionit, i cili, në fakt, është duke i ngulfatur dhe kërcënuar seriozisht proceset demokratizuese në vend. Prandaj, Kosova, jo rrallëherë, është renditur përkrah “shteteve të dështuara” – me nivel të jashtëzakonshëm të zhvatjes së parasë publike dhe abuzimit me autoritetin publik. Ngjashmërisht, edhe dy Raportet e fundit, të publikuara nga Komiteti Kombëtar mbi Politikën e Jashtme Amerikane dhe nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, janë në të njëjtën linjë të mendimit dhe njëherazi forcojnë një konstatim të tillë. Të dyja, këto, shquhen për zërin tejet kritik dhe të drejtpërdrejt për autoritetet vendore, të cilat janë të thirrura për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, por, për fat të mjerë, vet janë të zhytura dhe të përfshira në afera korruptive dhe krim të organizuar. Prandaj, institucionet tona, por edhe shoqëria në tërësi, duhet të angazhohen seriozisht për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, në mënyrë që Raportet e ardhshme, qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare,

ta pasqyrojnë Kosovën me një panoramë optimiste dhe shpresëdhënëse, e assesi përmes një tablo tepër të errët dhe të zymtë. Natyrisht, kjo nuk një rrugë e lehtë dhe e shkurtër. Përkundrazi, është përplot vështirësi. Por, përball nevojave dhe kërkesave të mëdha të shoqërisë, këto pengesa duhet tejkaluar dhe, për të mirën e përgjithshme, duhet sakrifikuar ngulmimin dhe prirjen për ta shpërdoruar pushtetin dhe paranë publike.

RAPORTI I KËSHILLIT KOMBËTAR MBI POLITIKËN E JASHTME AMERIKANE²⁸

Sipas këtij Raporti, njerëzit e qeverisë janë emëruar në postet kryesore të prokurorisë dhe gjyqësorit, të cilët janë përgjegjës për luftimin e korrupsionit. Më tutje, theksohet që një klikë e ngushtë qeveritare, e miqve dhe familjeve të qeveritarëve kontrollojnë kontratat e prokurimit – dhe, natyrisht, i fitojnë ato. Perceptimet për korrupsionin dhe abuzimit me autoritetin publik, sipas këtij Raporti, janë një indikator dhe dëshmojnë ngurrimin e qeverisë për të ndërmarrë veprime kundër shkelësve të profilit të lartë, duke përfshirë ministrat, zëvendës ministrat dhe nomenklaturën e partisë politike.²⁹ Në vazhden e kritikave të shumta për qeverinë e Kosovës, ky Raport nënvizon faktin

²⁸ Është Komiteti jo-përfitues dhe organizim aktiv i figurave qendrore amerikane. I themeluar me 1974. Merret me zgjidhjen e konflikteve që kërcënojnë interesat amerikane, duke identifikuar, artikulluar dhe ndihmuar avancimin e interesave të politikës së jashtme amerikane nga perspektiva jo-partiake, brenda kornizës së realizmit politik. Madje, edhe vet themeluesi i saj, Hans J. Morgenthau, konsiderohet si themelues i realizmit politik në kuadër të Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Për më shumë informata në lidhje me këtë publikim, mund të vizitoni webfaqen e tyre: <http://www.ncafp.org>

²⁹ David L. PHILLIPS – Realizing Kosova's Independence. National Committee on American Foreign Policy. New York. May 1, 2010, pg. 7

²⁷ <http://www.kosovopolice.com>, 28 Maj 2010

se krimi i organizuar është i pranishëm edhe në strukturat e pushtetit dhe partive politike. SHIK-u, shërbimi informativ i PDK-së, raportohet që merr 200 milion dollar për vit, përmes ryshfetit, grabitjes, raketitgut dhe shërbimeve të mbrojtjes. Ky Raport pohon, po ashtu, se Kosovës, jo vetëm që i mungon vullneti i Drejtësisë për ta çrrënjësuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, por edhe baza ligjore është e pamjaftueshme - si rrjedhojë e zbrastërave ligjore, ngase Kosova ende nuk e ka Ligjin Anti-Mafia” ose një ligj i cili do të konfiskonte pasuritë që janë fituar në mënyrë të paligjshme.³⁰ Megjithatë, sipas NCAFP, përgjegjësia për ta luftuar korrupsionin bie mbi Qeverinë e Kosovës, ku luftimi i tij duhet të fillojë që nga nivelet me të larta qeveritare. Sipas këtij Komiteti, qeveria mund ta dëshmojë vetveten duke shkarkuar ose arrestuar ministrat e përfshirë në praktikën korruptive...duhet ta fuqizojnë Agjencinë Kosovare të Anti-Korrupsionit dhe ta zbatojnë Planin dhe Strategjinë Kombëtare. EULEX-I, po ashtu, duhet ta shtyjë Qeverinë e Kosovës të jetë më pro-aktive dhe, nëse ajo ngurron, atëherë duhet të vet të prijë në këtë proces.... Edhe diplomatët mund t'i dënojnë veprimet korruptive.³¹ Ndërkaq, në pjesën e fundit të këtij Raporti, gjegjësisht tek Rekomandimet, i bëhet apologji institucioneve të Republikës së Kosovës që të angazhohen mirëfilli për t'i luftuar këto dukuri, të cilat janë duke e dëmtuar Kosovën në përmasa të mëdha dhe në të gjitha planet e mundshme.

³⁰ Po aty, fq. 8

³¹ Po aty, fq. 11

NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT³²

Përveç Raportit të NACFP, në muajin maj është publikuar edhe një Raport tjetër mbi zhvillimet në Kosovë nga ana e YIHR. Ky Raport, në fakt, më shumë trajton problematikën e lirisë së fjalës në kuadër të hapësirës publike, por, natyrisht, përfshihen edhe çështjet që kanë të bëjnë me qeverisjen, apo thënë më mirë, keq-qeverisjen në vendin tonë. Përgjatë këtij vlerësimi të YIHR, pasqyrohet një tablo argumentuese në lidhje me proceset deformuese që janë duke ngjarë në realitetin e Kosovës dhe, që realisht, janë duke e dëmtuar seriozisht procesin e shtet-ndërtimit dhe demokratizimit. Edhe Raporti i Nismës, sikundër edhe ai i NCAFP, adreson kritika në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar, e veçmas në adresë të SHIK-ut, i cili absorbon fonde në mënyrë të paligjshme nga ana e institucioneve dhe, ndonëse nuk janë brenda qeverisë, ata kanë një ndikim të madh dhe të theksuar në qeveri³³. Ky Raport kritikon partitë në pushtet (qeverinë e Kosovës) për praktika të tilla korruptive, të cilat janë duke e dëmtuar hapësirën publike të Republikës së Kosovës. Më tutje, thuhet se me miliona euro abuzohet nga praktikën e prokurimit³⁴. Ndërkaq, sa i përket përgjegjësisë për një katandisje të tillë, sipas Nismës, nuk duhet fajësuar vetëm partitë që janë duke qeverisur, sepse këto praktika të keq-qeverisjes janë trashëguar edhe nga qeveritë paraardhëse.

³² Është NGO Rajonale, e themeluar në vitin 2003. Veprimtaria e saj shtrihet në territoret e Serbisë, Kosovës, Malit të Zi, dhe Bosnje e Hercegovinës.

³³ YIHR – State of Constriction? Governance and Free Expression in Kosovo. Publikuar : 24 Maj 2010, Prishtinë, fq. 16

³⁴ Po aty, fq. 51

Prandaj, nuk ekziston asnjë dëshmi që duke zëvendësuar partitë në pushtet me partitë tjera në opozitë do të mund të shoqërohej njëkohësisht edhe me ndonjë përmirësim, kështu që asnjë forcë politike nuk duket e aftë të fitojë zgjedhjet dhe të ndryshojë sistemin e tanishëm³⁵.

RAPORTET NGA SHOQËRIA CIVILE

Edhe shoqëria civile në Kosovë, e cila pranohet gjerësisht se është esenciale për proceset demokratizuese në vendin tonë, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në luftë kundër korrupsionit dhe praktikave tjera korruptive. Qëllimi i aktiviteteve të shoqërisë civile, përkatësisht e organizatave jo-qeveritare, ka qenë denoncimi i praktikave korruptive dhe deformuese të keq-qeverisjes. Në këtë kontekst, gjatë muajit maj janë shënuar dy aktivitete të ndryshme nga dy organizata të ndryshme, po ashtu: nga Lëvizja FOL, e cila ka denoncuar listën e disa zyrtarëve që mbajnë poste të dyfishta në institucionet dhe ndërmarrjet publike dhe “Çohu”, e cila ka publikuar, në një tryezë të rrumbullakët me aktorë relevantë, dobësitë e kornizës ligjore, që rregullon fushëveprimin institucional në luftë kundër korrupsionit.

LËVIZJA “FOL”

Gjatë muajit maj, Lëvizja FOL, ka publikuar emrat e shtatë (7) zyrtarëve që mbajnë poste të dyfishta në institucionet publike të Republikës së Kosovës. Sipas FOL, këta zyrtarë janë në konflikt të pastër interesi, meqë të gjitha

dispozitat ligjore³⁶ i ndalojnë zyrtarët të ushtrojnë angazhime tjera në institucionet dhe ndërmarrjet publike, ku mund të ketë konflikt të pastër interesi. Emrat e apostrofuar janë: Xhevdet Smakiqi - këshilltar ligjor i Ministrisë të Transportit Fatmir Limaj dhe njëkohësisht zyrtar ligjor në Postë-Telekomin e Kosovës; Gani Koci - deputet dhe zyrtar ligjor në KEK; Besa Gaxherri - deputete dhe zyrtare në PTK, dega në Pejë; Slobodan Petrovic - deputet dhe koordinator në Zyrën për Komunitete në PTK; Gani Buqinca - deputet dhe redaktor në RTK; Nesrin Lushta - kryetare e KQZ-së dhe gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës; Florian Dushi - ushtrues detyre i sekretarit të përhershëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe në të njëjtën kohë është anëtar i KQZ-së nga LDK-ja. Këta emra, sipas Lëvizjes FOL, janë në konflikt të pastër interesi, ndaj edhe duhet sa më parë të japin dorëheqje në njërin nga pozitat që mbajnë, e assesi t'i mbajnë të dyja postet. Publikimi i këtyre emrave, nga ana e FOL, ka ndikuar pozitivisht dhe ka pasur efekt të menjëhershëm, ngase njëri nga emrat e përmendur, gjegjësisht Nesrin Lushta, në një takim me anëtarët e KQZ-së, i informoi ata se jep dorëheqje nga ky post.³⁷

ORGANIZATA “ÇOHU”

Gjatë muajit Maj, Organizata për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet “Çohu”, ka bërë prezantimin e të metave dhe dështimeve të kornizës ligjore kundër korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe deklaratimit, prejardhjes dhe

³⁵ Po aty, fq. 51

³⁶ Shih me shumë Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (2007/02-L133) dhe Ligjin e Anti-korrupsionit (2004/34), ngase të dyja këto ligje ndalojnë zyrtarët publikë të ushtrojnë funksione të dyfishta në institucionet dhe ndërmarrjet publike.

³⁷ <http://www.kospress.com>, 31 Maj 2010

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

kontrollit të pasurisë të zyrtarëve të lartë shtetërorë. Sipas “Çohu”, Ligjet e reja kundër korrupsionit, me gjithë faktin që shënojnë një përparim minimal për sa i përket kodifikimit juridik të luftës kundër korrupsionit, prapëseprapë nuk ofrojnë bazë adekuate dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit³⁸. Përveç kësaj, korniza ligjore kundër korrupsionit thekson aspekte preventive të luftës kundër korrupsionit, duke anashkaluar ato ndëshkuese. Në këtë publikim, po ashtu shprehet shqetësimi se kjo kornizë e vendosë Agjencinë Kosovare kundër Korrupsionit në një pozitë inferiore karshi nivelit të prezencës, llojit/formës së shfaqjes si dhe shtrirjes sektoriale të korrupsionit. Kjo pasi që ligjet e reja kundër korrupsionit i lejojnë Agjencisë kompetenca kryesisht në luftimin e të ashtuquajturit (korrupsion i butë/petty corruption), përderisa luftimi i (korrupsionit të lartë - grand corruption/political corruption) bëhet jashtëzakonisht i pamundur.³⁹

FALËNDERIME

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga USAID përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile i implementuar nga ISC – Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Institute for Sustainable Communities). Ky Raport, po ashtu, është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e

informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë webfaqe: www.monikorr.org

RRETH LËVIZJES “FOL”

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t’i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

TË DHËNAT E LËVIZJES “FOL”

Andrea Gropa 29, 100000 Prishtinë,

Republika e Kosovës

Mob: +377 (0) 44 131 542

Ueb: www.levizjafol.org

E-mail: info@levizjafol.org

³⁸ Lorik BAJRAMI - Gjatë prezantimit të Kornizës Ligjore Kundër Korrupsionit, mbajtur 28 maj 2010, Hotel Grand, Prishtinë.

³⁹ Më gjerësisht, shih publikimin e “ÇOHU”, i cili mund të shkarkohet në këtë webfaqe - <http://www.cohu.org>